

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – koleji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Mr.Sc. Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit E., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës D. S., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson N. M., avokat nga Prishtina, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AE.nr. 200/2014 datë 18.9.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 5 janar 2017, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës D. S., me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AE.nr. 200/2014 datë 18.9.2015.

#### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AE.nr.200/2014 datë 18.9.2015, refuzohet ankesa e të paditurës D. S., me seli në Prishtinë, dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.446/2012 datë 5.5.2014, me të cilin është shfuqizuar aktvendimi për lejimin e përmbarimit E.nr.667/2012 datë 8.10.2012, është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësit t’ia paguajë borxhin prej 34.303,67 €, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, për shumën e borxhit, prej 5.131.00 €, kërkesëpadia është refuzuar, si dhe është vendosur që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion me kohë ka paraqitur e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se palët ndërgjyqëse kanë qenë në marrëdhënie detyrimore kontraktuese në bazë të së cilës paditësi të paditurës i ka dërguar mall të cilin e paditura e ka pranuar me rregull, e ka nënshkruar edhe pranimin e faturës, mirëpo e paditura paditësit nuk i ka paguar në tërësi borxhin dhe ka mbetur borxhli për shumën prej 34.303,67 €, i cili borxh paraqet bazën e padisë së ushtruar.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur jokontestues faktinse malli pranë paditësit është porositur dhe në bazë të faturave malli është pranuar nga punëtori i të paditurës B. G., dhe nga i njëjti në emër të palës së paditur është nënshkruar procesi për barazim më datë 27.8.2012 dhe procesi i tij është vulosur me vulën e të paditurës. Andaj, duke u bazuar në dispozitën e nenit 170 të LMD-së, ka obliguar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë dëmin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimimit ka pranuar në tërësi konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm andaj ka refuzuar në tërësi si të pabazuar ankesën e të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se të dy gjykatat duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Aktgjykimi i goditur përmban arsye të mjaftuara faktike dhe juridike për faktet relevante të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të cilat kishin për të kontestuar ligjshmërinë e aktgjykimit, meqë nga provat e administruara në mënyrë të sigurt është vërtetuar fakti se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit që ka pësuar paditësi me veprimin e punonjësit të paditurës në vendin e punës duke ushtruar funksion të paligjshëm. I njëjti me qëllim të përfitimit të paligjshëm ka përvetësuar shumën e të hollave të paguara nga paditësi për mallin e porositur, ndërsa e paditura këtë mall nuk e ka pasur në dispozicion. Dispozita e nenit 170 të LMD-së parashikon përgjegjësinë e punëdhënësit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar personave të tretë në punë ose në lidhje me punën. Kusht për të ekzistuar përgjegjësia e punëdhënësit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar personave të tretë, sipas kësaj dispozite ligjore, në radhë të parë, është e nevojshme që dëmi të jetë shkaktuar gjatë punës apo në lidhje me punën. Kjo nënkupton se fakti dëmtues është shkaktuar gjatë procesit të punës në vendin e punës, në kuadër të fushëveprimit të funksionit të cilin ushtron punonjësi. Sikurse të dy gjykatat edhe kjo Gjykatë mendon se në rasti konkret janë plotësuar kushtet ligjore nga dispozita e sipër cituar që e paditura t'i përgjigjet paditësit për dëmin që e ka pësuar paditësi me veprimin e paligjshëm të punonjësit të paditurës në vendin e punës, duke ushtruar një funksion të paligjshëm me qëllim të përvetësimit të dobisë pasurore –përvetësimin e mallitë pranuar nga paditësi.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar provë me anë të ekspertizës financiare për të konstatuar dhe vërtetuar të gjitha mallrat që i ka përvetësuar paditësi, se në këtë rast gjykata e shkallës së parë është dashur ta ndërprerje procedurën gjere në plotfuqishmërinë se aktgjykimi PP.nr. 6077-12/12 lidhur me përgjegjësin e punëtorit të paditurës për abuzim detyre, kjo Gjykatë parashtrimet e tilla i cilësoi si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për të paditurën për faktin se parashtrimet e tilla nuk paraqesin referenca ligjore që ndikojnë në meritat e lëndës.

Së këndejmi, pretendimet në revizion, se aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë, janë marrë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme për faktin se në revizion përshkruhet konstatimi faktik dhe qëndrimi juridik i të dy gjykatave, përshkruhen gjendja faktike dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk janë saktësuar në kuptim të ligjit se ku

konsistojnë shkeljet e pretenduara, ndërsa gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin vetëm në pjesët e goditura konform dispozitës së nenit 215 të LPK-së.

Nga sa u tha më sipër e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr.36/2016, më 5 janar 2017

Kryetare e kolegjit,  
Gyltene Sylejmani